



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

Nr. 1308/1 Prot.

Pukë, më 15/10/2025

Lënda: Informacion mbi Zyrën e Konsumatorit pranë Bashkisë Pukë

Drejtuar: QENDRËS “KONSUMATORI SHQIPTAR”

Adresa: L.11, Rr. Kumini, Pall.1319, DURRËS

Në përgjigje të kërkesës për informacion, drejtuar Bashkisë Pukë, informojmë si më poshtë:

Pranë Bashkisë Pukë nuk funksionon dhe nuk është ngritur Zyra për Mbrojtjen e Konsumatorit. Kjo për arsye të pamundësisë strukturore dhe buxhetore.

Ankesat dhe çdo problematikë tjetër që lidhet me konsumatorët, trajtohen përmes zv.kryetarit përkatës që mbulon dhe këtë përgjegjësi funksionale, grupeve të posaçme dhe policisë bashkiake.

Jemi në dijeni të detyrimit për raportimin në lidhje me mbrojtjen e konsumatorëve, gjë të cilën do ta rikuperojmë me strukturën e re, duke caktuar një person përgjegjës.

Faleminderit për mirëkuptimin!

KRYETARI
Rrok DODAJ

